



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 01.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.10.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ri-Tender-Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparar, Sistem zërimi, ndricim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-10476-1-2-1, Nr. i brendshëm- 632-24-014-121, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "INFINITT" SH.P.K. e dt.24.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ri-Tender-Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparar, Sistem zërimi, ndricim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-10476-1-2-1, Nr. i brendshëm- 632-24-014-121, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 07.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Korrigjohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 07.10.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korrigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyctim

Operatori Ekonomik "INFINITT" SH.P.K me dt.24.10.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit " Ri-Tender-Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparati, Sistem zërimi, ndricim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-10476-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 01.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë, merret si i bazuar dhe në këtë pikë autoriteti kontraktues do të rregulloj specifikat;

Për pretendimin tuaj të dytë, sqarojmë se kamerat duhet të jene se paku day-night;

Pretendimi juaj i tretë nuk qëndron, sepse ky është një projekt i planifikuar dhe konstatohet se të gjitha aktivitetet janë të së njëjtës fushë;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

